



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:264634

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05633043

KPPP.nr.31/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “Amidon Group” SH.P.K., me NRB: 70614952, me seli në Graçanicë, fshatin Suhodoll, përfaqësuar sipas autorizimit nga Sabri Kryeziu, avokat nga Lipjani, kundër debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) SH.A., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.278/2021 të datës 27.10.2021, të Përbaruesit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.278/2021 të datës 27.10.2021, të Përbaruesit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr.278/2021 të datës 27.10.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi - Lubeniqi.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 78.00 € (shtatëdhjetë e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Amidon Group” SH.P.K., në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik III. Ek.nr.26/20 të dt. 11.01.2021, ka nxjerrë urdhrin P.nr.278/2021 të datës 27.10.2021, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbaimit, ndaj debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) SH.A., me seli në Prishtinë dhe ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin, në emër të shpenzimeve procedurale në shumë prej 1.921.40 € (një mijë e nëntëqind e njëzet e një euro e dyzet cent) si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbaimore për propozim për përmbaimit në shumën prej 156.00€ (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro) dhe shpenzimet tjera sa do të caktohen nga ana e përmbauesit privat ku urdhërohen bankat komerciale që veprojnë në Kosovë, që menjëherë posa ta marrin këtë titull përmbaimit, nga xhirollogaritë e debitorit që janë të hapura në këto banka, ti bartin mjetet materiale për të cilat është lejuar përmbaimit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbaimit, duke theksuar se dokumenti i bashkëngjitur propozimit për përmbaimit, përkatësisht aktgjykimi i plotfuqishëm, me qëllim të identifikimit të debitorit nuk përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 38 par 2 të LPP –së, organi përmbaues duhet të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa të anulohet urdhri për përmbaimit P.nr.278/21 dt. 27.10.2021, i Përmbauesit Privat Emine Sherifi – Lubeniqi, si i pa lejuar dhe i pa bazuar në ligj, duke e detyruar kreditorin edhe në pagimin e shpenzimeve procedurale.

Kreditori në përgjigjen në prapësim përmes përfaqësuesit të autorizuar, ndër të tjera ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe se i njëjti nuk mbështetet në asnjërën nga shkaqet e paraqitjes së prapësimit të cilat janë të renditura në mënyrë taksative në nenin 71 të LPP –së. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit ku të refuzohet si i pa bazuar, ndërsa urdhri të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet kreditori në pagimin e shpenzimeve procedurale dhe atë për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 156.00 €.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.712/22, të datës 02.09.2022, e ka hedhë poshtë prapësimin e debitorit si të pa afatshëm.

Debitorit me datë 13.09.2022, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, që të aprovohet ankesa, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë ta anuloj.

Gjykata Komerciale -Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1603/22 të datës 02.08.2022, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar aktvendimin e atakuar dhe çështja i është kthyer Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.26/2020 të datës 11.01.2021, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi. Gjykata gjeti se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.26/2020 i datës 11.01.2021, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, objektin e detyrimit të debitorit dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.26/2020 i datës 11.01.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “*Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri*”, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: “*Vërtetimin për përmbarrueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”, ngase Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.26/2020 i datës 11.01.2021, është bërë i plotfuqishëm me datë 16.09.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 12.10.2021.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarrimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, duke i’u njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë shumën prej 78.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.31/24, datë 29.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.